

PERMBAJTJA

MESAZHI I BUXHETIT TE VITIT 2012

- KAPITULLI I Informacion i pergjithshem mbi buxhetin e vitit 2012.
- KAPITULLI II Parashikimi te ardhurave ne Buxhetin e Bashkise Durres per vitin 2012
- II.1. Të ardhurat nga Taksat dhe Tarifate Vendore
- II.1.1 Të ardhurat nga Taksat Vendore
- II.1.2 Të ardhurat nga Tarifate Vendore
- II.2 Të ardhurat nga Buxheti i Shtetit (Transferta e Pakushtëzuar)
- KAPITULLI III Parashikimi shpenzimeve per vitin 2012
- III.1 Shpenzime personeli (art.600+601)
- III.2. Shpenzime operative dhe te mirembajtjes (art.602)
- III.3. Shpenzime subvencioni (art.603)
- III.4. Transferta tek individet dhe buxhetet familjare (art.606)
- III.5 Fondi rezerve dhe kontigjenca (art.609)
- III.6 Kontributi per Qarkun (art.604)
- III.7 Kontributet per projektet IPA (art.604)
- III.8 Shpenzimet kapitale (art.230 +231)
- KAPITULLI IV Programet e zhvillimit te qytetit
- Programi i Infrastrukturës Rrugore

Programi i Sherbimeve Publike

Programi i Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit

Programi i Trasportit Urban

Programi i Strehimit Social

Programi i Kujdesit Social

Programi i Kulturës dhe Turizmit

Programi i Rinisë dhe Sportit

Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim dhe Administrim)

KAPITULLI V Pasqyrat

ANEKS REALIZIMI I BUXHETIT TE BASHKISE DURRES PER VITIN 2011

MESAZHI I BUXHETIT TE VITIT 2012.

Në vijim të punës pesevjecare dhe eksperiencës së akumuluar tashmë, kam kënaqësinë të prezantoj projektin e të ardhurave dhe shpenzimeve të Qytetit të Durrësit për vitin 2012 . Puna e disa muajve për të përcaktuar ndërhyrjet në qytet ka filluar me vlerësimin e nevojave , por edhe të pritshmërisë së komunitetit për sa i takon prioritetet për të përmirësuar cilësinë e jetes së qytetarëve. Pavarësisht përballjes me një reduktim të ndjeshëm të të ardhurave të Qytetit të Durrësit , vazhdojmë me të njëjtën ambicje të jetësimi të prioritetet sipas të njëjtës përjasje atë të buxhetimit me pjesmarrje, i cili është bere nje model qe vjen e permiresohet nga viti ne vit .

Këndvështrimi qytetar i shprehur në formën e opinionëve apo perceptimeve për vitin 2011 apo nëpërmjet të gjithë formave apo mekanizmave të tjerë të thithjes së këtij mendimi na orientuan në hartimin e këtij projekt buxheti për vitin në vijim , profili i të cilit jepet si më poshtë:

- Përafrim i mëtejshëm i kapaciteteve tona planifikuese dhe menaxhuese në drejtim të investimeve në punë publike i kordinuar jovetëm me pritshmërinë në rritje të komunitetit , por edhe me politikën e zhvillimit të qytetit sipas një kuadri të integruar politikash të rregullimit të territorit ;
- Vazhdimin e përmirësimit të ndjeshëm të infrastrukturës rrugore
- Perdorim të mjeteve alternative të financimit me kredi për projektet e Banesave Sociale me qera.
- Bashkefinancimin në projekte në kuadër të bashkepunimit ndërkufitar të programit të paraaderimit në BE .
- Vijimin e investimeve për shtimin sasior dhe cilësor të hapësirave të gjelbërta , si dhe përmirësimin e shërbimeve të tjera publike , që ndikojnë pozitivisht për një rritje cilësore të jetës në qytet.
- Vijohet me një kontribut në rritje të shpenzimeve për shërbimet sociale , duke synuar një rritje cilësore dhe sasimore të tyre , por edhe në zgjerim shërbimesh.
- Vijohet me një rritje progresive të shpenzimeve në mirëmbajtjen e infrastrukturës së qytetit, kryesisht për rrugët e ndërtuara , objektet e arsimit , si dhe shërbimet e tjera publike.
- Plani i investimeve kapitale vazhdon me një shpërndarje ekualizuese drejt zonave informale dhe atyre në nevojë , përkundërt atyre formale dhe kontribuese në buxhetin e bashkisë , duke i dhënë një natyrë sociale rishpërndarjes së kontributeve të komunitetit.
- Prezantimi i buxhetit me programe sektoriale dhe prioritare të mbështetura në kostot reale, ku përcaktohen qartë objektivat për çdo sektor si dhe raporti produkt/rezultat.

Duke e mbyllur do t'ju ftoja ta miratojmë të gjithë se bashku këtë projekt -buxhet si një përgjigje qytetare dhe përgjegjshmeri politike të votuesve tanë për të ofruar shërbimet publike dhe përcaktuar politikën e zhvillimit të qytetit tonë.

Vangjush DAKO

Kryetar i Bashkisë DURRES

KAPITULLI I: INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BUXHETIN E BASHKISË DURRES PËR VITIN 2012.

Hartimi i Buxhetit per vitin 2012 vazhdon ne rrugen e nisur dhe te konsoliduar tashme nga administrata aktuale qe prej 5 vitesh me nje perfshirje tete gjitha institucioneve te vartese se Bashkise se Durresit ne kete proces.Hartimi i Buxhetit u perfshi ne nje cikël te plote buxhetimi sipas kerkesave ligjore , duke i ndjekur te gjitha hapat te percaktuara ne ligj. Kjo mënyrë e re buxhetimi e nisur qe ne vitin 2008 ka identifikuar dhe analizuar kostot e shërbimeve dhe të investimeve sipas objektivave të programeve dhe standartave në shërbime të ndryshme.

Ky Buxhet permban dhe pershkruan :

- Se si do te reflektohen ne buxhetin e vitit 2012 politikat fiskale te aplikuara
- Si do te ndikojne keto politika ne permbushjen e objektivave te Bashkise se Durresit.
- Si jane vendosur prioritetet per vitin 2012 per investimet kapitale.
- Si do te realizohen shpenzimet per permbushjen e funksioneve.

Të gjitha institucionet e ndermarrjet e varesise emertuar sipas ligjit “Njësi Shpenzuese” kanë përcaktuar aktivitetet që do të kryhen për arritjen e objektivave, produktet dhe kostot e tyre.

Buxheti i vitit 2012 garanton objektivat e tij për:

- Nje permiresim te paketes fiskale ne drejtim te permiresimit te detyrimeve fiskale ndermjet kategorive dhe grupeve te bizneseve , si dhe per listimin e tyre ne baze te aktivitetit qe kryejne.
- Përrjashtimin apo lehtësimin nga sistemi i taksave dhe tarifave për kategorinë e veteranëve, invalidëve të punës e të luftës, të verbërve, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, si dhe përjashtimin e institucioneve shtetërore qe kryejne vete sherbimin e grumbullimit te transportit te mbeturinave, por jane lehtesuar nga keto pagesa edhe kategoria e pensionisteve dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.
- Një përmirësim të shërbimit social duke aplikuar forma të punësimit nëpërmjet nxjerrjes nga skema e ndihmës ekonomike.
- Dhënien e stimulit financiar për nxënësit me rezultate te larta ne mesime ,
- Një nivel të pandryshuar të shpenzimeve administrative,
- Një nivel me të lartë të mirëmbajtjes në infrastrukturën publike, arsim, sherbime publike, etj-
- Vazhdimin e përfundimin e projekteve të nisura nga viti 2011.
- Investime të reja në infrastrukturën publike.

Programi buxhetor financiar për vitin 2012 bazohet në analizën e kostove të programeve dhe shërbimeve në vite si edhe në vendimmarrjen për rritjen e standarteve apo cilësisë së tyre. Këto analiza janë shoqëruar edhe me zbatimin e metodave të reja të buxhetimit, të cilat garantojnë zbatimin e politikave në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të burimeve financiare, në përputhshmëri me ndikimin e programeve të ndryshme në zhvillimin ekonomik të qytetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetin. Teknikat e përdorura për hartimin e buxhetit janë :

- Përgatitja e buxhetit bazuar në detyra/program. Kjo formë kërkon një klasifikim të ri të aktiviteteve e detyrave.
- Përgatitja e buxhetit të balancuar. Kjo formë detyron formulim të qarta të prioriteteve në çdo nivel organizativ.

Njesite Pjesmarrese në Buxhetin 2012 janë :

- 1- Aparati i Administratës së Bashkisë së Durrësit.**
- 2- Ndermarrjet dhe Institucionet e Varesisë.**

Të gjitha institucionet e ndermarrjet e varesisë emertuar sipas ligjit “Njësi Shpenzuese” kanë përcaktuar aktivitetet që do të kryhen për arritjen e objektivave, produktet dhe kostot e tyre.

Parashikimi I shpenzimeve bëhet për çdo kategori të shpenzimeve aktuale. Çdo shpenzim parashikohet në bazë të parashikimit të personelit , operimit dhe mirëmbajtjes si dhe shpenzime të tjera.


Parashikimi I të ardhurave bëhet në të njëjtën mënyrë si parashikimi I shpenzimeve duke ju referuar çdo takse dhe tarifë , të cilat analizohen në hollësi.

Buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2012 është një buxhet i balancuar ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve i programuar në vlerën 1 784 273 061 leke.

KAPITULLI II: PARASHIKIMI TE ARDHURAVE NE BUXHETIN E BASHKISE DURRES PER VITIN 2012

Për vitin 2012 të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë DURRES parashikohen në shumën 1.784.973.061 leke. Këto të ardhura përbëhen nga të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore dhe nga transfertat e pakushtëzuar sipas tabelës së mëposhtme:

Emertimi	Plan 2011	Plan 2012
Te ardhurat nga taksat e tarifatat te vitit korrent	1.300.000.000	1.300.000.000
Te ardhurat e trashjegura nga viti I meparshem	400.011.865	93.586.061
Transferta e pakushtëzuar	393.205.000	390.687.000
TOTALI	2.093.216.865	1.784.273.061



II. 1 TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE

Të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore për vitin 2012 janë programuar në shumën **1.300.000.000** lekë.

Ky programim ka në themel të vet:

- Rritjen e arkëtimit të të ardhurave nëpërmjet thellimit të vazhdueshëm të punës në drejtim të evidentimit dhe regjistrimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në qytetin e Durrësit

- Uljen e evazionit fiskal nëpërmjet uljes se numrit të debitorëve
- Përmirësimin e kushteve të biznesit dhe thjeshtimit të procedurave tatimore
- Përmirësimin e sistemit informatik në programin e taksave

Te ardhurat nga taksat e tarifat vendore grupohen në:

✚ Te ardhura tatimore.

Për vitin rreth 2012 këto të ardhura arrijnë në shumën 1.048.580.000 leke , ose 2 % me pak se planifikimi i vitit 2011 dhe me nje rritje ne masen 48 % nga fakti i vitit 2011 , dhe do të vazhdojnë të jenë burimi kryesor i të ardhurave të veta te Bashkisë Durrës ku 80.7 % e te ardhurave te veta e zënë te ardhurat tatimore .


✚ Te ardhura jo tatimore.

Të ardhurat jo tatimore për vitin 2012 parashikohen në rreth 251.420.000 lekë ose 10 % më shumë se planifikimi i vitit 2011 dhe 10.2 % me shume se fakti i vitit 2011.

Një ecure e të ardhurave për periudhën 2007-2012 paraqitet si me poshtë:

Emërtimi	Fakt 2007	Fakti 2008	Fakti 2009	Fakti 2010	Fakti 2011	Plani 2012
Ardh:Tatimore	637.963.595	699.779.882	917.015.738	761.240.991	705.147.343	1.048.580.000
Ardh.Jo.tatim	163.206.893	184.844.546	187.248.641	221.664.253	228.203.531	251.420.000
Totali	801.170.488	884.624.428	1.104.264.379	982.905.244	933.350.874	1.300.000.000

Në lekë



Më poshtë prezantohet një analizë më e detajuar mbi parashikimin e çdo të ardhure nga Taksat e Tarifat Vendore


Këshilli Bashkiak Durres me vendimin Nr.11 dt.29.09.2011 "Per miratimin e realizimit te Buxhetit te Bashkise Durres te vitit 2010 dhe detajimin e Buxhetit te Bashkise Durres te vitit 2011" ka miratuar ne buxhetin e Bashkisë së Durresit për vitin 2011, planin e të ardhurave te veta te Bashkise në shumën 1.300.000.000 lekë .

Për vitin 2011, të ardhurat e veta te Bashkise janë realizuar në shumën 933.350.874 lekë ose 72 % kundrejt planit vjetor të miratuar prej 1.300.000.000.

Numri i subjekteve të evidentuara vitn 2011, nga struktura e DTTV është konfirmuar në 5046 subjekte aktive gjithsej.

Tabela e mëposhtëme paraqet një informacion mbi struktura e numrit te subjekteve aktive gjithsej.

Lloji i biznesit	Nr. Sub/aktive/tot
BV	2635
BM	1142
Ambulant	961
Transport	308
TOTALI	5046



Krahasuar me vitin 2010 per të njëjtën periudhë kemi një ulje të të ardhurave në shumën 49.554.369 lekë duke iu referuar faktit të vitit 2010. Më konkretisht, ky krahasim paraqitet si më poshtë:

E m ë r t i m i	Realizimi i vitit 2010	Realizimi i vitit 2011	Diferenca 2011 - 2010
------------------------	-------------------------------	-------------------------------	------------------------------

Të ardhura tatimore	761.240.991	705.147.343	-56.093.648
Te ardhura jo tatimore	208.476.886	210.693.459	2.216.573
Sponsorizime dhe Donatorë	3.331.950	3.549.390	217.440
Gjobat	9.855.417	13.960.683	4.105.266
TOTALI	982.905.244	933.350.875	-49.554.369

Mbështetur në praktikat shumë vjeçare dhe në metodologjinë e zbatuar të deritanishme, parashikimi i treguesve mbi të ardhurat për periudhat e mëvonshme ka si bazë realizimin aktual të tyre së bashku me rritjen ekonomike të vendit si dhe politikat dhe strategjitë e projektuara për të ardhmen .

Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2012 mbështetet kryesisht në të dhënat si më poshtë

- Nivelet e taksave dhe tarifave vendore të miratuara në Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar dhe vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak të Durrësit.
- Realizimin faktik të të ardhurave vitin 2011 dhe tendencën deri në fund të vitit;
- Numrin e subjekteve aktivë të evidentuar nga struktura e DTTV-së;
- Parashikimin e të ardhurave nga subjekte debitorë kryesisht ato të vitit 2011
- Parashikimin e ndryshimeve të numrit të subjekteve që do të ndodhin gjatë vitit 2012 si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit 9920 dt 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore"
- Parashikimin e të ardhurave nga subjektet që mund të rregjistrohen të reja gjatë vitit 2012
- Parashikimin e të ardhurave nga agjentët tatimore.
- Parashikimi i të ardhurave nga lejet e ndertimit të miratuara
- Parashikimi i të ardhurave nga Drejtoria e Urbanistikës
- Parashikimi i të ardhurave nga Departamenti i Sherbimeve

Sipas të dhënave të fundvitit 2011 në rregjistrin vendor të DPTTV-së, rezulton se në qytetin e Durrësit ushtrojnë aktivitetin e tyre 5046 subjekte tregtare .Me poshte po pareqisim levizjen e numrit te subjekteve gjate vitit 2011.

Nr. I subjekteve aktive ne fillim te vitit 2011	5381
Nr. I subjekteve qe nuk kane aplikuar PER VIITN 2011	250
Nr. I Subjeteve te reja gjate vitit 2011	694

Pra subjekte qe kane ushtruar aktivitetet gjate vitit 2011 jane gjithsej 6075 subjekte

Nr.i subjekteve te cregjistruara gjate vitit 2011	611
Nr.i subjekteve te pezulluara gjate vitit 2011	418
Nr i subjekteve akive ne fillim te vitit 2012	5046

Lidhur me parashikimin e subjekteve për vitin 2012 sic shihet nga trendi i viteve te fundit numri i subjekteve aktive ka ardhur duke u ulur nga rritja e numrit te subjekteve qe mbyllin dhe qe pezullohen vetem nga viti 2010 ne vitin 2011 kemi nje ulje te numrit te subjekteve aktive prej 335 subjektesh keshtu qe per vitin 2012 mendojme qe te rrimen ne te njejtin nivel subjektesh aktive si ne vitin 2011 duke u nisur dhe nga kriza qe po kalon biznesi ne pergjithesi, pra numri i bizneseve qe mbyllin dhe pezullojme te jete sa ai qe hapen te reja.

II.1.1 TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE

Taksa mbi Pasurine

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për kategorinë Biznes është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Durrësit.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për kategorinë “Ndërtesa Banimi” është POSTA Sh.a dhe agjentet pranë njesive vendore

Për vitin 2011 janë evidentuar 102.888.253 lekë të ardhura nga kjo taksë përkatësisht 89.314.437 lekë të arkëtuara prej subjekteve dhe 13.573.816 lekë të arkëtuara nga familjaret.

Në total, të ardhurat e kësaj takse te vitit 2011 janë realizuar 84% te planit vjetor.

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë për vitin 2012 parashikohet në shumën **126.000.000 lekë** pra kemi nje planifikim prej 23.111.747 leke me te madh se realizimi i vitit 2011 qe mbështetet në:

- Të dhënat e subjekteve për taksën e ndërtesës. Për kategorinë e ndërtesave të banimit sipas informacionit ne baze te te dhenave te DTTV dhe për kategorinë e ndërtesave të tjera sipas të dhënave të regjistrit vendor,
- Të dhënat mbi numrin dhe vlerën e debitorëve kryesisht te viti 2011 për këtë taksë,
- Të dhënat mbi numrin e subjekteve taksapaguese të reja si pasojë e shtesave të sipërfaqeve të taksueshme,

- Të dhënat mbi realizimin faktik të kësaj takse për vitin 2011, duke analizuar faktorët pozitiv dhe negativ,

Baza e taksës

Per kategorine biznes jane të dhënat e subjekteve për taksën e ndërtesës
Për kategorinë e Ndërtesave të Banimit informacioni sigurohet nga baza e te dhenave te DTTV dhe vetedeklarimi i familjareve.

Kategoria e Familjarëve

Numri i Familjeve pagues per vitin 2011 parashikohet te shkoje ne 39.000 familje, dhe do te arketohet pranë agjentit tatimor (POSTA), dhe agjenteve tatimor prane Njesive Vendore.

Sqarojme se numri i familjareve mbi te cilen llogariten te ardhurat e popullates per taksen e pasurise eshte rreth 39.000 familje pasi ketu jane zbritur 4000 familje te cilet perfitojne lehtesimet nga kjo takse .Planifikimi i te ardhurave nga kjo takse per kete kategori do te jete 34.000.000 leke.

Persa i perket planifikimit te taksës se pasurise per kategoria familjare do te kemi nje rritje ne masen 150% kundrejt realizimit te vitit 2011 duke u mbeshtetur ne rritjen e bazez se familjeve paguese nga masat e marra per organizimin e mbledhjes se kesaj takse per vitin 2012 nga Bashkia.

Kategoria e Ndërtesa të tjera (biznesi)

Sipas të dhënave të regjistrimit vendor (subjektet taksapagues) rezulton se për vitin 2011 janë të regjistruar për taksën e ndërtesës **3.667 subjekte taksapaguese** sipas këtyre fushave:

Kategoritë e Ndërtesave	Nr. Subjekteve (aktiv-total)	Sip	% / kategorive
Kategoria e Prodhimit	292	131.735	26 %
Kategoria shërbim dhe tregti	3.339	376.723	74%
Totali i Subjekteve 2010	3.631	508.458	100 %

Për sa më sipër, per planifikimin e pasurise per kategorine biznes për vitin 2012 mendojmë qe te kete nje rritje me vlere prej 2.685.563 leke dhe nje rritje ne masen 3% kundrejt realizimit te vitit 2011. Pra te ardhurat e planifikuara pe r kete kategori do te jene **92.000.000 leke**

Taksa e Biznesit të Vogël

Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, qoftë ky subjekt fizik apo juridik, vendas apo i huaj, me anë të të cilit realizohet një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) e barabartë ose më e vogël se 8.000.000 lekë.

Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janari i vitit të ardhshëm fiskal.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Duke ju referuar planit vjetor te vitit 2011 për këtë taksë prej 260.000.000 lekë, gjatë këtij viti janë arkëtuar 197.016.292 lekë ose 76 % e planit vjetor.

Llogaritja e kësaj takse është mbështetur në Udhëzimin nr.655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore” dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.123.dt.26.12.2008 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, duke marrë në konsideratë:

- *Të dhënat e Regjistrimit Vendor për Taksapaguesit e Taksës Vendore të Biznesit të Vogël,*
- *Realizimit faktik të kësaj Takse gjatë vitit 2011, duke evidentuar faktorët pozitiv dhe negativ të vërejtur gjatë kësaj periudhe,*
- *Të dhënat mbi regjistrimet e reja, c’regjistrimet dhe pezullimet e aktivitetit për këtë kategori Taksapaguesish për vitin 2011,*
- *Kalimet ne biznes te madh*
- *Faktorë të tjerë që ndikojnë në këtë Taksë për vitin 2012 sic eshte ndikimi i krizes ekonomike.etj.*

Hapja e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, përveç faktorëve pozitiv në drejtim të shkurtimit të procedurave administrative dhe tatimore për regjistrim shoqërohet dhe me fenomenin e moskontrollit tatimor të subjekteve në fazën e regjistrimit, pasi këto subjekte deklarojnë xhiron e tyre vjetore pranë këtyre strukturave dhe mund ta hapin dhe mbyllin biznesin e tyre në çdo kohë.

Gjatë vitit 2011 janë rregjistruar pranë QKR-së rreth 694 subjekte të reja .

Kjo shifër pa dyshim që nuk mund të konsiderohet një rritje e numrit të subjekteve pasi kjo shoqërohet edhe me rritjen e numrit të bizneseve që ç’rregjistrohen dhe rritjen e numrit të bizneseve që pezullojnë aktivitetin gjatë vitit ,pra për vitin 2011 shihet një rënie e numrit të subjekteve aktive pasi rezulton se numri i subjekteve të mbyllura dhe

pezulluara është me i madh se numri i subjeteve të hapura që kanë uljen e numrit të subjekteve me 335 subjete.

Parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë për vitin 2011, planifikohet në shumën **260.000.000 lekë**, pra nuk parashikohet rritje e kësaj takse duke e krahasuar me planifikimin e vitit 2011 dhe parashikohet një rritje në masën 32% ndaj faktit të vitit 2011 kjo si pasojë e tendencës së shumë subjekteve për ulje të nivelit të xhiros dhe mbylljen e biznesit të tyre.

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë kësti i katërt i vitit 2011 dhe 3 kësti i parë, i dytë dhe i tretë i vitit fiskal 2012. Sipas akteve ligjore kësti i katërt i vitit 2011 paguhet deri më 20 Janar të vitit pasardhës fiskal.

Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3 % të shumës së arkëtuar.

Viti 2011 ka regjistruar shumën 53.036.237 lekë të arkëtuar nga kjo taksë, kundrejt një planifikimi prej 45.000.000 leke pra kemi një realizim në masën 118% ndaj planifikimit vjetor .

Ky tregues ndiqet rregullisht nga strukturat e DTTV, punë e cila reflektohet në akt-rakorimet mujore me këtë agjent dhe që konfirmohet edhe nga Dega e Thesarit.

Për vitin 2012 është parashikuar në shumën **52.000.000 lekë** parashikim që behet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Taksa e Mjeteve të përdorura.

Në zbatim të ligjit Nr.10 457 dt.21.07.2011 “ Për disa ndryshime në ligjin nr 9632 dt 30.10.2006 Për sistemin e Taksave vendore, i ndryshuar” ku pika 6 (Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve) e Nenit 9 shfuqizohet.

Në zbatim të Ligjit Nr.10 458 dt.21.07.2011 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.9975, dt.28.07.2008 PER TAKSAT KOMBETARE, i ndryshuar” Pika 3 ku 18% e të ardhurave vjetore të “Taksës Vjetore të Mjeteve të Përdorura” i kalojnë buxhetit të qeverisjes

vendore.

Për vitin 2011, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor ka evidentuar 17.208 automjete të regjistruara pas kryerjes së kolaudimit të tyre prej të cilëve ka arkëtuar 49.582.600 lekë ,e shprehur ne perqindje kemi nje realizim ne masen 99% kundrejt planit vjetor te parashikuar 50.000.000 leke.

Per vitin 2012 nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor jane planifikuar 58.000.000 leke.

Taksa e Tabelës per qellime identifikimi

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e transportit dhe profesioneve të lira.

Per vitin 2011 janë arkëtuar 544.652 lekë ose 109% e planit vjetor.

Parashikimet per te ardhurat nga ky ze per vitin 2012 eshte në shumën **550.000 lekë** , pra me nje rritje nga planifikim i vitit 2011 me 10% dhe nga fakti me 1% kjo per arsye se nuk parashikojme rritje te numrit te subjekteve aktive.

Taksa e Tabelës per qellime reklamimi

Taksa e reklamës është detyrim vjetor. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria Urbanistikës në momentin e zbardhjes së lejes së përkohshme të vendosjes se reklamave.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2011 kapin shifrën 6.106.800 lekë , duke patur nje realizim te ulet kundrejt planifikimit ne masen 31%, takse e cila planifikohet dhe ndiqet nga Drejtoria e Urbanistikes.

Kjo takse aplikohet mbi te gjitha subjektet te cilet shfrytezojne hapsirat per te reklamuar produkte dhe sherbime te cilat lidhen me aktivitetin qe kryejne.

Te ardhurat nga kjo takse per vitin 2012 parashikohen te jene prej 18.000.000 leke. Planifikimi i kesaj takse eshte bere duke u nisur nga siperfaqet e reklamave qe firmat reklamuese kane vendosur ne qytetin e Duresit dhe niveleve te percaktuar ne ligj.

Taksa për zënien e hapësirave publike.

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m2, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Taksa për zënien e hapësirës publike përbëhet prej:

- Taksës për zenie e hapsires publike Spektakle ose panaire te ndryshme
- Taksa per zenie e hapsires publike (Perdorim trualli per tavolina)
- Taksës për zenie hapësirë publike me mallra jashte vendit te tregtimit
- Takses per zenie hapsire publike me platforma me kngjella vazo drure dekorativ etj;

Per vitin 2011 janë arkëtuar 3.336.276 lekë, kundrejt nje planifikimi prej 5.000.000 leke pra kemi nje realizim prej 66.7 % te planifikimit vjtor, dhe respektivisht jane realizuar 1.461.720 leke nga perdorimi per veprimtari ekonomike dhe 1.874.556 leke per vendosje tavolinash jashte objekteve te ushtrimit aktivitetit.

Pavaresisht nga realizimi të kësaj takse per vitin 2011 parashikimi per vitin 2012 kap vleren **5.130.000 lekë** duke bere nje planifikim 3% me te madh se planifikimi i vitit 2011 dhe 54% me te madh se fakti i ketij viti. Konkretisht kemi nje planifikim prej 2.000.000 leke per vendosje tavolinash jasht objekteve te ushtrimit te aktivitetit dhe 3.130.000 leke per veprimtari ekonomike.

Taksa e përkohshme e gjelbërimit.

Taksa e gjelbërt, paguhet nga të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë ose ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Durrësit. Kjo taksë është vjetore dhe likuidimi i saj detyrimisht bëhet brenda 20 Prillit të çdo viti.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksës së përkohshme të gjelbër nga subjektet është Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikes per subjektet qe marrin leje ndertimi.

Agjenti tatimor për mbledhjen e taksë së përkohshme te gjelbër për kategorinë e familjarëve eshte POSTA sha dhe agjentet tatimore prane Njesive Administrative.

Viti 2011 ka evidentuar realizimin e saj në shumën gjithsej 21.961.931 lekë nga të cilat 1.644.800 lekë nga Familjaret dhe 20.317.131 lekë nga Subjektet, duke pasur nje realizim respektivisht 55% nga popullata dhe 92% nga subjektet.

Nisur nga rezultatet e deritanishme, per vitin 2012 parashikimi i te ardhurave nga ky ze eshte 21.000.000 leke ose 4% me te ulta se realizimi i vitit 2011 kjo dhe kjo vje se

parashikimi i të ardhurave nga debitoret për vitin 2012 është shumë i ulët nga zbatimi i ligjit të faljeve.

Parashikimi i taksës së gjelbër për vitin 2011, është llogaritur si më poshtë vijon:
Nga kategoria biznesit në vlerën 18.000.000 leke dhe nga kategoria familjare 3.000.000 leke.

Taksa e perkoheshme e tregut

Kesaj takse i nënshtrohen të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregjet publike në administrim të Bashkisë Durrës.

Për vitin 2011 realizimi është 10.508.320 leke ose 98% ndaj planit vjetor

Baza e kesaj takse është sipërfaqja në m² për tregtimin e artikujve të ndryshëm dhe kjo takse llogaritet si detyrim mujor.

Të ardhurat nga kjo takse për vitin 2012 janë planifikuar në vlerën **11.100.000 leke** dhe planifikimi i kesaj takse varet nga numri i banakeve që janë vendosur në këto treg dhe tarifa për çdo m² e miratuar në KB.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Urbanistikës.

Për vitin 2011 janë arkëtuar 161.106.790 lekë ose 50% e planit vjetor.

Parashikimi i të ardhurave nga kjo takse e ka bazën në të ardhurat që realizohen nga pagesa për zbardhjen e lejeve të ndërtimit të miratuara nga K.RR.T-ja pranë Bashkisë së Durrësit në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave në qytetin e Durrësit" dhe kërkesave të subjekteve për leje ndërtimi.

Parashikimi i të ardhurave nga Taksa e ndikimit kryesisht është bazuar në llogaritjet e lejeve të ndërtimit që nuk janë zbardhur në vitin 2011 për mungesë dokumentacioni dhe parashikohet të jetë 464.300.000 leke pra të ketë rritje me vlerë 303.193.030 lekë.

Taksa e Fjetjes në Hotel.

Baza e taksës së fjetjes në hotel, është çmimi i fjetjes, për dhomë ose për person, për një natë. Janë subjekt i Taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie. Niveli i taksës është 2.5 % e çmimit të fjetjes.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Durrës.

Per vitin 2011 e ardhura nga kjo takse është 3.573.220 leke ndaj planit vjetor që është 4.000.000 leke pra kemi një realizim në masën 89% ndaj planit vjetor.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2012 parashikohen të kapin shifrën 2.500.000 lekë, pra do të kemi një ulje me 30% ndaj faktit të vitit 2011. Parashikimi i të ardhurave nga hotele është parashikuar me ulje në nivelin e tarifës së kësaj takse është përgjysmuar me vendimin e K.B nga 5% në 2.5%.

II.1.2 TË ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE

Në këtë grup të ardhurash përfshihen të gjithë të ardhurat me natyrë jo tatimore, që rezultojnë nga ofrimi i shërbimeve publike, të drejtat e përdorimit të pronave publike dhe vendore, dhënie e lejeve, liçensave, autorizimeve etj. Këto të ardhura zënë rreth 18.9% të të ardhurave të veta të bashkisë. Të ardhurat nga ky zë për vitin 2011 ishin 176.820.962 leke kundrejt 183.750.000 leke të planifikuara ose e shprehur në përqindje 96% kundrejt planit vjetor. Për vitin 2012 planifikimi i këtij zëri është në vlerën 203.390.000 leke, pra me një rritje në masën 15% kundrejt realizimit të vitit 2011. Me poshtë po japim planifikimin sipas zerave të këtij grupi të ardhurash.

Tarifa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme

Tarifa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme është e menjëhershme dhe paguhet vetëm një herë me krijimin dhe regjistrimin e subjektit për fillimin e aktivitetit ekonomik. Struktura e ngarkuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme është Departamenti i Taksa dhe Tarifave Vendore. Për vitin 2011 të ardhurat nga kjo tarifë janë 5.895.306 lekë pra paraqitet me një realizim në masën 84% dhe varet nga numri i bizneseve të reja të hapura rrishtazi.

Për vitin 2012 planifikimi i të ardhurave nga kjo tarifë është **5.000.000 leke**.

Në përlogaritjen e kësaj vlere janë marrë për bazë numri i subjekteve të reja që do të hapin për vitin 2012.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave.

Tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave i nënshtrohen të gjithë: familjet, personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, të cilët banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të qytetit të Durrësit.

Agjentet për mbledhjen e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjarët për vitin 2012 janë "POSTA"sha dhe agjentet pranë njesive bashkiake për të gjithë subjektet e tjera struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarifë është Drejtoria e

Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikes per subjektet qe marrin leje ndertimi..

Për vitin 2011, janë arkëtuar 81.185.259 lekë ose 83% e planit vjetor. Në këtë realizim përfshihen si të ardhurat e arkëtuar nga DTTV prej subjekteve ,Drejtoria e Urbanistikes dhe kategoria familje.

Më konkretisht për vitin 2011, nga DTTV dhe D.Urbanistikes janë arkëtuar 67.194.450 lekë kundrejtë 75.000.000 lekë të planifikuara. Gjithashtu nga familjaret janë arkëtuar 13.990.809 lekë kundrejt planit prej 23.000.000 lekë

Këto shifra të realizimit te vitit 2011 kane mundësuar per te kryer parashikimin e tarifes se pastrimit per vitin 2012 duke u mbështetur edhe në:

- Të dhënat e subjekteve për tarifën e pastrimit. Për kategorinë e tarifës së pastrimit për familjarët janë marrë në konsideratë të dhënat sipas informacionit nga baza e te dhena ve ne D.T.T.V dhe Vendimit te K.B,ndërsa për kategorinë e tarifës së pastrimit për biznesin janë marrë në konsideratë të dhënat sipas databeizit te regjistrit vendor;
- Të dhënave mbi realizimin faktik të kësaj tarife për vitin 2011 me qëllim analizimin e faktorëve pozitiv dhe negativ;

Kjo tarifë duke qenë e lidhur ngushtësisht me tërë llojet e biznesit në qytetin e Durrësit, duke përfshirë këtu dhe ambulancat, tregtarët e tregjeve etj, fenomeni i hapjes dhe mbylljes së aktivitetit brenda vitit fiskal për shkak të konkurrencës, ndikon negativisht në realizimin e kësaj tarife pasi subjektet që mbyllin në gjashtëmuorin e parë dhe ato që hapin gjashtëmuorin e dytë ngarkohen me 50% të nivelit të taksës.

Pavarësisht këtij fakti faktor pozitiv mbetet ndërgjegjësimi i taksapaguesve për këtë shërbim mjaft të rëndësishëm të qytetit, shprehur dhe në opinionet qytetare, faktor ky që shoqëruar me kontrollin në terren dhe një identifikim të saktë të subjekteve parashikojmë të sjellë rezultate pozitive në parashikimin e kësaj Tarife për vitin 2012.

Bazuar në sa më sipër, propozojmë një parashikim të kësaj tarife në vlerën prej **100.000.000 lekë** për vitin 2012, nga të cilat **77.000.000 lekë** për tarifën e pastrimit nga kategoria e biznesit dhe 23.000.000 lekë nga kategoria e familjareve, pra me një rritje në masën 23% kundrejt realizimit të vitit 2011.

Përsa i përket tarifës së pastrimit nga kategoria e familjarëve, parashikojmë që nga Agjentët Tatimor sic janë POSTA dhe ato prene Njesive administrative të merret një e ardhur prej **23.000.000 lekë**, me një numër prej 30.000 familje si pasoje e masave

lehtesuese per kete tarife per disa kategori te shprehura ne V.K.B Nr. 195.18.01.2010 ku perfitojne rreth 13.000 familje.

Tarifa e plazheve Private

Kjo tarife aplikohet mbi te gjithë subjektet qe shfrytezojne siperfaqen e reres ne vijen bregdetare per plazhe private gjate periudhes se sezonit turistik

Per vitin 2011 e ardhura nga kjo takse eshte 16.200.000 leke kundrejt 25.000.000 leke te planifikuara pra kemi nje realizim ne masen 65%.

Te ardhurat nga kjo tarife per vitin 2012 jane planifikuar ne shumen **25.000.000 leke**, ne te njejtin nivel me planifikimin e vitit 2011.

Tarifa e parkimit.

Të ardhurat e tarifës së parkimit për vitin 2011, janë realizuar në vlerën 13.912.460 lekë kundrejt planit vjetor prej 14.000.000 lekë ose 99%.

Rezultatet e deritanishme kanë krijuar mundësinë që për vitin 2012 të ardhurat e tarifës së parkimit të ulen me 4% ndaj faktit të vitit 2011 dhe të planifikohen në shumën **13.300.000 leke**.

Tarifa e ndricimit

Objekt i kesaj tarife do te jene të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë ose ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Durrësit. Kjo tarife është vjetore dhe likuidimi i saj detyrimisht bëhet brenda 20 Prillit të çdo viti.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës së ndricimit nga subjektet është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Agjenti tatimor për mbledhjen e tarifës së ndricimit për kategorinë e familjarëve është POSTA sh.a dhe agjentet tatimore pranë Njesive Administrative.

Viti 2011 ka evidentuar realizimin e saj në shumën gjithsej 10.638.297 lekë nga të cilat 1.575.096 lekë nga Familjaret dhe 9.063.200 lekë nga subjektet.

Vlen të theksohet se për vitin 2011, të ardhurat nga tarifa e ndricimit prej subjekteve, që arkëtohet nga DTTV, kemi një realizim në masën 101% kundrejt planifikimit vjetor, pra realizimi i kesaj tarife në masen 89% vjen nga mosrealizimi i kesaj tarife nga familjaret qe paraqitet me nje realizim ne masen 53%..

Nisur nga rezultatet e deritanishme, per vitin 2012 te ardhurat nga kjo tarife jane parashikuar ne shumen 24.000.000 leke ose 126% me larte se realizimi i vitit 2011, si rezultat edhe i rritjes se nivelit te kesaj tarife me vendimin nr 39. Dt 1117.01.2012 "Per sisteme taksave vendore ne qytetin e Durrësit" dhe per kategorine familjare ne saje te masave te marra nga bashkia per rritjen dhe te bazez se tyre.

Parashikimi i tarifes se ndricimit për vitin 2012, është llogaritur si më poshtë vijon:
Nga kategoria e biznesit ne vleren 18.000.000 leke dhe nga kategoria familjare 6.000.000 leke, Pra te ardhurat nga tarifa e ndricimit per vitin 1012 parashikohen te jene ne shumen **24.000.000 Leke**

Tarifa e transportit publik

Kjo tarife perlllogaritet nga Drejtoria e Sherbimeve dhe planifikimi i kesaj te ardhure per vitin 2012 eshte **3.850.000 leke** kundrejt nje realizimi te vitit 2011 prej 3.295.875 leke pra kjo tarife parashikon nje rritje ne masen 17 % ndaj realizimit te vitit 2011. Kjo per arsye se keto tarifa jane 5 vjecare keshtu qe nuk mund te kete nje vijushmeri te njejte te pagesave.

Te ardhura nga tarifat e sherbimit

Kjo tarife perlllogaritet nga Drejtoria e Sherbimeve dhe planifikimi i kesaj te ardhure per vitin 2012 eshte **3.100.000 leke** kundrejt nje realizimi te vitit 2011 prej 965.000 leke pra kjo tarife parashikon nje rritje te konsiderueshme ndaj realizimit te vitit 2010 .

Tarifa e shërbimit veterinar

Planifikimi i kësaj të ardhure llogaritet nga Sektori Veterinar pranë Drejtorisë së Shërbimeve dhe për vitin 2012 është llogaritur në vlerën **1.140.000 leke**. Kjo tarifë ka ruajtur të njëjten vlerë të realizimit të vitit prej 1.130.899 leke..

Tarifa e përdorimit

Me këto tarife ngarkohen të gjithë subjektet që marrin lejen e shfrytëzimit. Kjo tarifë për vitin 2012 është llogaritur në vlerën **15.000.000 leke** dhe për llogaritet dhe ndiqet nga Drejtoria e Urbanistikës

Tarifa e Urbanistikës

Kjo tarifë për vitin 2012 është llogaritur në vlerën **13.000.000 leke** për shërbimet që iu ofrohen firmave ndërtuese. Kjo tarifë llogaritet dhe mbledhet nga Drejtoria e Urbanistikës.

Te ardhura të tjera

Për këtë zë të të ardhurave për vitin 2012 janë parashikuar të arkëtohen të ardhura në shumën 20.880.000 leke, ku përfshihen:

1. Të ardhura nga veprimtari të ekonomike (dhenie qera) 11.200.000 leke.
2. Sponsorizime 1.680.000 leke.
3. Të ardhura nga gjobat 8.000.000 leke.

Te ardhura nga gjobat

Kjo e ardhur për vitin 2012 është planifikuar në vlerën **8.000.000 leke**

Kjo tarifë do të aplikohet në të gjithë subjektet që nuk do të respektojnë afatet e pagesave të percaktuara në ligj nga Drejtoria e Taksave e tarifave Vendore dhe planifikohet të jetë në vlerën 5.000.000 Leke , dhe nga Policia Bashkiake , Inspektoriat i Ndertimit, planifikohet një e ardhur në vlerën 3.000.000 leke.

Te ardhura nga institucione

Planifikimi i të ardhurave nga Institucionet për vitin 2012 është në vlerën **27.150.000 leke**. Këto të ndara sipas zerave janë:

1. Të ardhura nga pagesat e prindërve për çerdhe 6.750.000 leke

2. Te ardhura nga pagesat e prinderve per kopshtet 17.400.000 leke
3. Te ardhura nga pagesat e per konviktet 1.800.000 leke
4. Te ardhura nga instucionet Kulturore,Sportive 1.200.000 leke

II.2. TE ARDHURA NGA BUXHETI I SHTETIT (TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR)


Cdo vit Buxheti i Shtetit me miratimin e ligjit per buxhetin percakton dhe shumen e trasferetes se kushtezuar dhe te pakushtezuar.

Transferta e pakushtëzuar (granti) është e ardhur e përfituar në forme dhurimi, për një qëllim të përcaktuar ose jo, pa kusht kthimi dhe pa interes, që përdoret për financimin e veprimtarive ekonomike. Kjo transfertë akordohet nga pushteti qendror, pa kusht kthimi dhe pa interes.

Për vitin 2012 transferta e pergjithshme e pakushtëzuar për Bashkine e Durresit paraqitet në shumën 390.687.000 leke ose 9.278.000 mije leke më pak se viti 2011.

Ecuria e kësaj transferte paraqitet në tabelë dhe grafikisht:

Emertimi	në leke					
	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Transferta e pakushtëzuar	242.856.000	407.636.000	433.031.000	383.724.000	381.409.000	390.687.000
Grant konkurues I Ministrise se Brendshme		5.000.000	44.000.000	20.777.850	60.000.591	
Total	242.856.000	412.636.000	477.031.000	404.501.850	441.409.591	390.687.000



Shenim : Duke filluar qe nga viti 2008 ne baze te ligjit vjetor te buxhetit te shtetit pjese e transfertes se pakushtezuar jane edhe grantet konkuruese te MB per infrastrukturen vendore.

Sipas ligjit per "Buxhetin e shtetit per vitin 2012", pjese e kesaj transferte jane edhe fondet e granteve konkuruese te Ministrise se Brendshme per infrasrukturen rrugore, te cilat duke filluar qe nga viti 2010 jane rikonceptuar me emertimin " Fondi per Zhvillimin Rajonal", por deri ne muajin shkurt 2012 nuk eshte alokuar asnje fond i tille.

Edhe per vitin 2012 vazhdojne kufizimet per perdorimin e transfertes se pakushtezuar e konkretisht :

1. Bashkite qe kane mbi 50001 banore , perdorin deri ne 15% te transfertes se pakushtezuar per koston e personelit administrativ (punonjesit e aparatit te Bashkise)
2. Bashkite perdorin jo me pak se 10% te transfertes se pakushtezuar per mbeshtetjen e pentarise dhe gjelberimit. Rregullat , procedurat e skema e financimit dhe bashkefinancimit miratohen me vendim te vecante te Keshillit te Ministrave.



KAPITULLI III: PARASHIKIMI SHPENZIMEVE NE BUXHETIN E BASHKISE DURRES PER VITIN 2012

Programimi i shpenzimeve të përgjithshme sipas funksioneve të Bashkisë së Durrësit për vitin 2012 parashikohet në vlerën 1.784.273.061 leke .

Ky parashikim mbështetet në objektivat e Bashkisë së Durrësit të përcaktuara në programin e saj 4 vjeçar 2011-2015.

Karakteristikat kryesore të shpenzimeve të programuara për vitin 2012 përcaktojnë:

- Rritjen me përparësi të shpenzimeve në sektorët prioritarë si infrastrukture, shërbime publike, strehim, shërbim social.
- Procedura të buxhetimit të fokusuar tek produkti/rezultati, për çdo program ne vecanti
- Ruajtjen të pandryshueshëm të nivelit të shpenzimeve administrative në bazë të normimit të tyre,
- Rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes në shërbimet publike duke iu përgjigjur në këtë mënyrë tendencës të rritjes së investimeve në vite,
- Planifikimin e investimeve afatgjata dhe prioritare duke sjellë cilësi në rritje në dy drejtime:
 - ◇ Të vlerësimit e zgjedhjes së projekteve të investimeve duke mbajtur parasysh kërkesat më emergjente dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave të komunitetit,
 - ◇ Sigurimin e shpërndarjes me përparësi të investimeve në projekte të rëndësishme të bazuara në vlerësime dhe studime paraprake,

Shpenzimet e përgjithshme sipas natyrës ekonomike në buxhetin e vitit 2012 paraqiten si më poshtë :

ARIKULLI	PLANI 2011	Plani 2012
Shpenzime personeli	565.058.000	574.162.000
Shpenzime operative	367.825.000	378.859.455
Subvencione	35.000.000	35.000.000
Kuota Qarkut	15.000.000	12.000.000
Kontributi Bashkisë për projektet IPA		5.000.000
Transferime tek buxh. familjare dhe individët	6.900.000	12.235.780
Rezerva dhe kontigjenca	29.000.000	20.000.000

Studime Projektme	29.612.973	27.411.280
Investime	1.044.820.892	719.604.546
TOTALI	2.093.216.865	1.784.273.061

III.1. SHPENZIME PERSONELI (art.600+601)

Shpenzimet për personelin janë parashikuar në masën 574.162.000 leke ose leke (2%) më shumë se ato të planifikuara për vitin 2011, e konkretisht:

1. Fondi i pagave i planifikuar për vitin 2012 do të jetë 495.427.405 leke , pra 9.292.405 leke më shumë, ose 2 % më i lartë se ai i planifikuar për vitin 2011.
2. Për vitin 2012 shpenzimet e planifikuara për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jenë 78.734.595 leke , pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2011

Si përfundim për vitin 2012 do të financohen nga buxheti i Bashkisë Durrës një numër punonjësish prej 960 vetash , i njëjti me vitin 2011.

Në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet e personelit për të gjitha njësitë shpenzuese për vitin 2012:

Ne 000/ leke

Njesite shpenzuese :	2011			2012		
	Nr.pun.	paga	Sig.shoq	Nr.pun.	paga	Sig.shoq
Aparati i Bashkisë	240	152.506	23.973	240	155.160	24.514
Nd. Sherbimeve komunale	365	164.582	26.175	365	163.767	25.906
Nd.komunale Plazh	116 *	53.716	8.781	116 *	55.273	8.840
Nd. Rrugeve	50	23.692	3.768	50	27.096	4.309
Kl. Shumesporteve	19	9.421	1.498	19	9.813	1.561
Kl. Futbollit	7	3.328	556	7	3.404	569
Q.kulturore	40	20.739	3.312	40	21.686	3.503
Biblioteka	14	8.617	1.372	14	8.789	1.468

Q.ek.arsimit (cerdhet)	60	22.644	4.680	60	24.545	3.958
Q.ek.arsimit (konviktet)	29	14.68	2.969	29	13.380	2.127
Q.ditore te moshuarve	15	7.123	1.193	15	7.443	1.239
PIU	5	5.399	646	5	5.074	741
TOTALI	960	486.135	78.923	960	495.427	78.335

*) Nga keto 30 veta jane puntore sezonale me kontrate.

Shenim: Per vitin 2012 duke filluar nga muaji maj ne baze te vendimit te Keshillit Bashkiak NR.46 DT.6/04/2012 sherbimi i ndricimit me 8 veta dhe dekorit me 3 veta do te administrohen nga Ndermarrja rrugeve, qe dote thote qe nr. i punonjesve te Ndermarrjes se sherbimeve komunale duka filluar nga dt.1 Maj 12 zbret ne 354 veta, kurse nr. i punonjesve te Ndermarrjes se rrugeve arrin ne 61 veta . Keshtu eshte ndare edhe fondi i pagave , sigurimeve shoqerore, si dhe shpenzimeve operative.

III.2. SHPENZIME OPERATIVE DHE TE MIREMBAJTJES (art.602)

Për vitin 2012, në total shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë projektuar në shumën 378.859.455 lekë ose 3 % me shume krahasuar me programin e vitit 2011. Racionalizimi i shpenzimeve operative dhe të administratës vazhdon të jetë pjesë e pandryshuar e programit të shpenzimeve për vitin 2012.

Ne 000/lekë

	Viti 2011	Viti 2012
SHERBIMET PUBLIKE	133.000	145.348
❖ Pastrimi dhe largimi mbetjeje urbane	67.400	72.000
- Nd.komunale sherbimeve	43.000	44.000
- Nd.komunale plazh	24.400	28.000
❖ Mirembajtja hapësirave te gjelberta	8.600	7.700
- Nd.komunale sherbimeve	8.000	7.300
- Nd.komunale plazh	600	400
❖ Mirembajtja ndricimit	4.500	4.700
- Nd.komunale sherbimeve	4.500	840
- Nd. Rrugeve		3.860
❖ Energjia elektrike per rruget	45.000	53.000

❖ Sherbim i Dekorit	5.800	5.800
- Nd.komunale sherbimeve	5.800	1.050
- Nd. Rrugeve		4.750
❖ Mirembajtje varrezash	1.700	1.900
❖ Vendime gjyqsore*)		248

*) Ne zerin vendime gjyqsore eshte parashikuar fondi per ekzekutim te vendimit gjyqsor per demshperblim per largim nga puna te punonjesit A.Elezi ne Nd.kom. Plazh.

Shpenzimet ne sistemin e sherbimeve publike jane planifikuar duke patur parasysh :

- ◇ Koston reale për njësi të këtij shërbimi, duke përfshirë në të të gjithë elementet e pastrimit, si atë të grumbullimit të mbetjeve urbane dhe atyre inerte , jo vetëm në rrugë, por edhe në ambjentet e tregtimit. Për rritje të cilësisë së shërbimit janë përfshirë në kosto edhe elemente të tilla si larje speciale e rrugëve me presion, mirëmbajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve, dezinfektimin e tyre, pastrimin e reres ne pergjate bregdetit etj.
- ◇ Zgjerimin e sipërfaqes së pastrimit edhe në zonat periferike dhe informale të qytetit.
- ◇ Analizën mbi gjendjen ekzistuese të sipërfaqeve të gjelbra, te ndricimit te rrugeve, si dhe nevojat e ndërhyrjes në mirëmbajtjen e tyre, mbështetur në koston për njësi të ndërhyrjes, si dhe vlerën përkatëse.

MIREMBAJTJA RRUGEVE E TROTUAREVE	5.800	6.540
❖ Ndermarrja rrugeve	5.800	6.200
❖ Vendime gjyqsore*		340

*) Ne zerin vendime gjyqsore eshte parashikuar fondi per ekzekutimi vendimit gjyqsor per demshperblim per largim nga puna te punonjesit E. Jazexhi ne Nd. rruga.

Ky planifikim ka në themel analizën mbi sistemin rrugor, duke mundësuar krijimin e një baze të dhënash mbi gjendjen ekzistuese të tyre, duke përfshirë edhe sinjalistikën e tyre, përcaktimin e volumeve të dëmtimeve të rrugëve, si dhe nevojat e ndërhyrjes në mirëmbajtjen e tyre, mbështetur në koston për njësi të ndërhyrjes.

KULTURA E TURIZMI	24.765	28.000
--------------------------	---------------	---------------

❖ Institucionet kulturore	13.765	12.200
- <i>Q.Kulturore</i>	10.107	9.000
- <i>Biblioteka</i>	3.658	3.200
❖ Projekte per aktivite te kulture e turistike	11.000	15.000
❖ Vendime gjyqsore*)		800

*) Ne zerin vendime gjyqsore eshte parashikuar fondi per ekzekutim vendimit gjyqsor per demshperblim per largim nga puna te 2 punonjesve XH. Tafai e M. Tafai ne Q.Kulturore.

SPORTI	51.000	51.390
❖ Institucionet sportive		
- <i>Klubi shumesporteve</i>	30.000	30.000
- <i>Klubi futbollit</i>	21.000	21.000
- Vendime gjyqsore		390

Ne zerin vendime gjyqsore eshte parashikuar ekzekutimi vendimit gjyqsor per demshperblim per largim nga puna te punonjesit Sh. Ballgini ne Kl. E shumesporteve.

ARSIMI PARAUNIVERSITAR	69.673	68.497
❖ Q.ek.arsimit	56.117	57.327
- <i>kopshtet, shkollat 9 vjevare</i>	44.257	45.617
- <i>shkollat e mesme</i>	3.380	3.850
- <i>konviktet</i>	8.480	7.860
- <i>vendime gjyqsore*</i>		466
❖ Q.kulturore femijeve	5.000	4.500
❖ Stimulimi i nx.sh. te mire	1.500	1.500
❖ Qeraja shkolles B.Curri	7.056	4.70

*) Ne zerin vendime gjyqsore eshte parashikuar ekzekutimi vendimit gjyqsor per demshperblim per largim nga puna te punonjesit I.Smajli ne Q.ek.arsimit.

Ne planifikimin e shpenzimeve per sistemin parauniversitar jane parashikuar shpenzimet per mirembajtjen e objekteve arsimore duke perfshire edhe kopshtet , nevojat e nderhyrjes per mirembajtjen e tyre, sigurimin me baze materiale e didaktike per shkollat, sigurimin e ushqimit per femijet e kopshteve dhe nxenesve ne konvikte, mundesimin e funksionimit te Qendres Kulturore te Femijeve, si dhe aktivitete kulturore argetuese per femijet. Gjithashtu vazhdojne te programohen edhe stimuj financiare per femijet qe kane rezultate te shkelqyera ne mesime apo jane fitues te Olimpiadave.

SISTEMI SHERBIMEVE SOCIALE	19.146	21.185
❖ Qendra ditore e te moshuarve		
(ushqim, mirembajtje)	5.875	5.920
❖ Cerdhet (ushqim, mirembajtje)	9.907	12.510
❖ Projekte sociale	1.364	2.255
❖ Pune ne komunitet	1.500	
❖ Shtepia e foshnjes	500	500

Për vitin 2012 Bashkia Durres do të vazhdojë të ofrojë shërbime në kuadër të përkujdesjes sociale të grupeve në nevojë, duke zhvilluar mekanizma efikase, për t'i ardhur në ndihmë komunitetit, si:

- Funksionimi i Qendres Ditore te Moshuarve
- Sigurimi i sherbimit te mirerritjes se femijeve ne cerdhe
- Bashkia do të vijoje te mbështesë Projektet Sociale me karakter ndërgjegjësues dhe sensibilizues për të gjitha aktivitetet në kuadër të ditëve kombëtare dhe ndërkombëtare të solidarizimit, fushata sensibilizuese per problematikat sociale , fushata informuese per sherbimet sociale qe ofron Bashkia etj.

ADMINISTRATA VENDORE	62.491	55.900
❖ Aparati i Bashkise	39.822	40.335 *
❖ Keshilli Bashkiak	7.236	7.493
❖ Vendime gjyqsore	15.433	8.072

*) Ketu jane perfshire fondet per ekzekutimin e vendimeve gjyqsore per largim nga puna te 2 punonjesve K. Kuci dhe L.Stenaj.

Ne grupin e shpenzimeve per vendime gjyqsore jane planifikuar fondet per likujdim pjesor te detyrimeve qe rrjedhin ne zbatim te Urdhrave te Permbarimit per ekzekutimin e vendimeve gjyqsore si me poshte :

1. Fondi prej 4.000.000 leke per likujdim pjesor te detyrimit qe rrjedh nga Urdhri nr.04.706 Prot. Dt.5/10/2011 i Zyres Permbarimore Durres per ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv nr.991 dt.05/05/2006 te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Durres sipas te cilit Shoqerise Bashkimi i pagohet detyrimi qe rrjedh nga kontrata e siper marrjes ne vleren 6.177.355 leke dhe 432.415 leke taksa permbarimore
2. Fondi prej 556.000 leke per likujdim pjesor te detyrimit qe rrjedh nga Urdhri nr. 104/1 dt.06.07.2011 i Zyres Permbarimore Durres per ekzekutimin e Vendimit nr.667 dt.13.06.2000 te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Durres per shlyerjen e detyrimit kundrejt qytetarit Theofan Muzina per vleren 1.090.244 leke.
3. Fondi prej 2.000.000 leke per likujdim pjesor te detyrimit qe rrjedh nga Urdhri nr. 1634/1 dt.12.10.2010 i Zyres Permbarimore Durres per ekzekutimin e Vendimit nr.297 dt.01.02.2008 te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Durres per shlyerjen nga Bashkia te personave te trete te paditur nga qytetari Shaban Paftali ne vleren 37.700 \$ dhe 744 \$ taksa permbarimore.
4. Fondi prej 1.516.000 leke per likujdim pjesor te detyrimit qe rrjedh nga Shkresa nr. 1523 dt.01.11.2011 e Zyres Permbarimore Durres per vendosjen e mases se sekuestros nga Dega e Thesarit te shumes 3.031.837 leke per demshperblimin e qytetarit Astrit Shpuza .

III.3. SHPENZIME SUBVENCIONI (art.603)

Ne kete grup shpenzimesh futet subvencioni qe i jepet Parkut te Udhetareve per te mbuluar koston e sherbimit te transportit urban . Per vitin 2012 subvencionimi i Parkut urban per diferencen e cmimit te abonese dhe biletas se transportit urban do te jete ne vleren 35 000 000 leke , pra I njejte me vitin 2011.

III.4. TRANSFERTA TEK INDIVIDET DHE BUXHETET FAMILJARE (ART.606)

Ne kete kategori pagesash perfshihet fondi social prej 6.000.000 leke qe do te ndahet ne forme cash sipas kriterave te vendosura ne Keshill Bashkiak per familje te varfra e me probleme sociale perfshire edhe jetime qe jetojne ne kujdestarine e gjysherve,

pagesat per individet qe i perfitojne ato sipas kriterëve te percaktuara ne ligje e udhezime (Invalidet e luftes) ne vleren 900. 000 leke, fondi per demshperblimin e familjeve te permbytura gjate dimrit prej 4.906.950 leke , fond per demshperblim per djegie shtepie prej 428.830 leke.

III.5 . FONDI REZERVE DHE KONTIGJENCA (ART.609)

Ne buxhetin e vitit 2012 është parashikuar një fond në shumën 20.000.000 leke si kontigjencë dhe fond rezervë, per te perballuar shpenzime te paparashikuara , nevojën e kryerjes se financimeve te reja apo shtim te financimeve mbi fondet e miratuara

III.6. KONTRIBUTI PER QARKUN

Ne baze te ligjit nr.8652 dt. 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 18, njesite e qeverisjes vendore derdhin nje kuote per llogari te Keshillit te Qarkut . Per vitin 2012 kete kuote e kemi planifikuar ne vleren 12.000.000 leke

III.7. KONTRIBUTI I BASHKISE PER PROJEKTET IPA CROS BORDER.

Bashkia Durres eshte perfituese e fondeve te Programit IPA Adriatic Cros Border 2007-2013 per 3 projekte : SIMPLE, TURGRATE dhe ADRIMOB . Ne baze te marreveshjes se partneritetit te nenshkruar midis perfituesve te ketyre projekteve , cdo perfitues , ne rastin konkret Bashkia Durres eshte kontribuese ne vleren 15% te vleres se projektit. Projektet jane te shtrira ne vitet 2011-2014. Vlera e ketyre projekteve eshte perkatesisht:

TURGRATE 220.000 Euro, financimi nga IPA eshte 85% = 187.000 Euro, financimi i Bashkise 15% =33.000 euro. Per vitin 2012 Bashkia do te kontribuojë me 2.200 mije leke.

ADRIMOB (Levizshmeria e qendrushme ne zonen e Adriatikut) 183.800 Euro, financimi nga IPA eshte 85% = 156.230 Euro, financimi i Bashkise 15% =27.570 euro. Per vitin 2012 kontributi i Bashkise per kete projekt do te jete 1.800 mije leke.

SIMPLE 183.800 Euro, financimi nga IPA eshte 85% = 86.241 Euro, financimi i Bashkise 15% = 15.219 euro. Per vitin 2012 kontributi i Bashkise do te jete 1.800 mije leke.

Pra ne total financimi i Bashkise per vitin 2012 per tre projektet se bashku do te jete 5.000 mije leke.

Shpenzimet per projektet do te kontrollohen dhe vleresohen nga njesia e kontrolloreve te nivelit te pare (FLCO) prane Ministrise se Integritit dhe ne baze te Deklaratese se vlefshmerise se shpenzimeve (DVE) te leshuar nga FLCO do te behet rimbursimi i shpenzimeve nga fondet e programit IPA. Keto projekte jane me skeme te pjeshme Thesari.

Me hollesisht per keto projekte flitet ne kapitullin IV : "Programet e zhvillimit te qytetit"

III.8. SHPENZIMET KAPITALE (ART.230+231)

Planifikimi per vitin 2012 eshte mbështetur duke marrë në konsideratë kërkesat e komunitetit, te qendrave administrative dhe te njesive shpenzuese, mbështetur në objektivat 2011-2015 te Bashkise Durres per zhvillimin e qytetit duke mbajtur ne vemendje:

- Analizën e performancës se kryerjes se investimit,
- Shkallen e ndikimit të pritshëm në zhvillimin ekonomik e social,
- Përputhshmërinë me zhvillimet rajonale,
- Numrin e përfituesve nga zbatimi i investimeve,
- Shkallen e ndikimit në reduktimin e varfërisë dhe rritjes së aksesit në kryerjen e shërbimeve ndaj komunitetit,
- Prioritetet e përcaktuara në takimet me komunitetin, duke krijuar mundësinë e vendimmarrjes se qytetarëve në buxhet,
- Investime më shumë në sektorët prioritarë dhe të domosdoshëm për qytetin,
- Kostot për njësi të përcaktuara për investim,
- Financim të projekteve me kosto të plotë të shtrirë në dy vite kalendarike.

Edhe për vitin 2012 Bashkia Durres ka në vëmendje të saj financimin e investimeve për objektet në vazhdim .

Mbështetur në ligjin organik te buxhetit, ligjin vjetor te buxhetit te shtetit per vitin 2012, Bashkia Durres planifikon investimet kapitale per tre vitet e ardhshme 2012-2014 sipas programeve dhe prioriteteve të zhvillimit, në mbështetje të funksioneve të përcatuara në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore" duke i paraqitur Këshillit Bashkiak për miratimin e programeve në nivel projekti si më poshte:

Shpenzimeve Kapitale sipas programeve paraqiten si me poshtë:

Nën Programi i investimeve sipas Programeve	Plan 2011 (000 Leke)	Plan 2012 (000 Leke)
Programi i infrastrukturës Rrugore	718.860	394.713
Programi i Shërbimeve Publike	208.057	194.181
Programi i Infrastrukturës Arsimore.	8.694	63.914
Programi i Shërbimeve Sociale	26.790	8.481
Programi i Kulturës dhe Turizmit		
Programi i Rinise e Sportit	3.839	3.839
Programi i Administratës Vendore	5.476	5.956
Programi i Strehimit Social	102.718	75.931
TOTALI	1.074.434	747.016

Nga shuma e mesiperme e planifikuar per vitin 2012 kemi investime te kontraktuara ne vitin 2011 te cilat jane ne proces e do te mbarten ne vitin 2012 ne shumen 484.935 mije leke.

Me poshte po paraqesim ne menyre te detajuar objektet ku do te investohet ne vitin 2012, te ndara sipas nenprogrameve:

Shpenzimet kapitale ne infrastrukturen rrugore:

Ne kete program shpenzimet kapitale (art. 230 +231) kapin shifren **394.713.092 leke** , te ndara si me poshte:

- Studime –projektme (art.230) 10.382.080 leke
- Investime (art.231) 384.331.012 leke

- ◇ Ne kete program investimet ne proces nga viti i kaluar 239.813.092 kapin shifren leke.
- ◇ Objektet e reja ku do te nderhyhet per vitin 2012 do te kapin vleren 149.900.000 leke dhe jane:
 - Rikonstruksion shetitore Taulantia (Faza II)
 - Rikonstruksione te 3 kurtallave perkatesisht ne L.18, L.17, L.5
 - Rikonstruksion te 4 rrugeve ne zonen e unazes se Plazhit dhe 4 rrugeve ne L.8
 - Rikonstruksion i rruges se Parthineve Plazh
 - Rikonstruksion i rruges se shqipeve ne Plazh(ndermjet frigoriferit dhe postes)
 - Ndertim kabine elektrike tek stadiumi
 - Mbyllje kanali ne Plazh
 - bashkefinansim me ndermarrjen e ujesjellesit per nderrimin e tubacioneve te ujesjellesit dhe kanalizimeve.
 - sinjalistike rrugore
 - Blerje asfalto beton

Shpenzimet kapitale ne sektorin e sherbimeve publike

Shpenzimet kapitale per vitin 2012 ne kete program jane planifikuar ne shumen **leke** te ndara si me poshte:

- | | |
|-------------------------------|--------------|
| - Studime projektme (art.230) | 11.690 leke |
| - Investime (art.231) | 182.490 leke |

Investimet ne proces nga viti i kaluar per kete program kapin vleren 123.812 leke

Investimet e reja ne kete program per vitin 2012 jane parashikuar ne vleren 46.300.000 leke dhe do te jene :

- Rivitalizimi sheshit tek Tirana Bank
- Rikualifikim fasadash
- Gjelberim ne qytet
- Ndertim banjo ne plazh
- Blerje kamioncine

Shpenzimet kapitale ne sektorin e arsimit parauniversitar

Shpenzimet kapitale ne kete program kapin vleren **63.914.396 leke** . Ato perfshijne:

1. Investimet ne proces nga viti i kaluar 4.514.396 leke
2. Investime te reja qe kapin vleren 59.400.000 leke
 - Rik. Kopshti 1 Qershori

- Blerje pajisje per konviktet
- Rik. Palestra shk. Sh. Mazreku
- Rrethimi i shk. Gj. Kastrioti.
- Rikonstruksion i shkolles "N.Frasherit"
- Rikonstruksion i shkolles "J.Kukuzeli"

Shpenzimet kapitale ne sektorin e sherbimeve sociale

Shpenzimet kapitale per vitin 2012 ne kete program do te jene **8.481.432 leke**. Ato perfshijne investime ne proces nga viti i kaluar.

Shpenzimet kapitale ne sektorin e sportit

Shpenzimet kapitale per vitin 2012 ne kete sektor jane planifikuar ne vleren 3.83.800 leke. Ato jane vlera e projekt zbatimit per ndertimin e nje pishine, fond i prokuruar ne 2010 .

Shpenzimet kapitale ne programin e administrates vendore


Shpenzimet kapitale per kete program jane planifikuar ne shumen **5.956.000 leke** .

Ato perfshijne :

1. Perfundimin e fazes se III-te te informatizimit te Bashkise ne vleren 2.976.000 leke
2. Blerje pajisje inventar ekonomik ne vleren 1.000.000 leke
3. Kontributin e Bashkise ne vleren 1.500.000 leke per projektin "Permiresimi i aftesive konkurruese ne nivel vendor" . Ky projekt do te hartohet ne bashkepunim me IFC.
4. Blerje e ortofotos se qytetit me vlere 480.000 leke

Shpenzimet kapitale ne programin e strehimit social.

Shpenzimet kapitale ne kete program jane parashikuar ne vleren **75.931.000 leke** . Ato perfshijne kontributin e Bashkise per ndertimin e banesave sociale me kredi nga CEB.



Ne kete kapitull po ju prezantojmë buxhetin e vitit 2011 sipas programeve.

Ky programim mbështetet në politikat sektoriale dhe prezanton aktivitetet e të gjitha Njësiave Shpenzuese për vitin 2012 për arritjen e objektivave dhe realizimin e produkteve të pritshme sipas kostove përkatëse.

Programet sipas funksioneve dhe sektorëve prioritarë të Bashkisë DURRES, për vitin 2012 prezantohen si në vijim.

1. **PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE.**
2. **PROGRAMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE.**
3. **PROGRAMI I ARSIMIT PARA-UNIVERSITAR DHE EDUKIMIT.**
4. **PROGRAMI I TRANSPORTIT PUBLIK DHE LEVIZSHMËRISË**
5. **PROGRAMI I STREHIMIT.**
6. **PROGRAMI I KUJDESIT SOCIAL DHE SOLIDARITETIT,**
7. **PROGRAMI I KULTURËS DHE TURIZMIT**
8. **PROGRAMI I RINISË DHE SPORTIT**
9. **PROGRAMI I ADMINISTRATËS VENDORE (PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI)**

Totali i shpenzimeve të Bashkisë (korente dhe kapitale) në lekë, për çdo program mbështetur në të ardhurat e veta paraqitet në tabelë e mëposhtëme:

		<i>Në lekë</i>	
Nr	Programet	Plan 2011	Plan 2012
1	Shërbimet Publike	594.310.931	597.468.806
2	Infrastruktura Rrugore	752.120.869	428.504.092
3	Arsimi Para-Universitar dhe Edukimi	95.703.442	147.918.396
4	Transporti Publik dhe levizshmeria	35.000.000	36.800.000
5	Strehimi social	110.813.064	83.746.300
6	Kujdesi Social	88.475.759	80.084.052
7	Kultura dhe Turizmi	58.705.000	65.646.000
8	Rinia dhe Sporti	69.641.800	70.575.800
9	Administrata Vendore	288.446.000	273.529.615
	Totali	2.093.216.865	1.784.273.061

PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE

Përshkrimi i programit	Programi i infrastrukturës rrugore parashikon ndërtimin, rikonstrukcionin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, segmenteve rrugore dhe nyjeve si dhe rehabilitimin e blloqeve të banimit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.
Politika e programit	Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standarteve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal si dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara.
Objektivat e politikës së programit	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Ndërhyrje komplekse të cilat synojnë krijimin e një infrastrukture rrugore bashkëkohore mbi dhe nëntokësore. ❖ Rikonstrukcioni i plotë i rrjetit rrugor ekzistues nëpërmjet zgjerimit, asfaltimit, rikonstrukcionit të trotuareve, infrastrukturës nën e mbitokësore, të të gjitha rrugëve ekzistuese kryesore dhe sekondare, ❖ Ndërtimi i Rrugëve të reja, ❖ Ndërhyrjet në blloqe banimi, rrugë parësore dhe dytësore. ❖ Studime dhe projektme për objekte të reja apo dhe për rikonstrukcione, ❖ Mirëmbajtje e infrastrukturës rrugore (asfaltim, shtrim trotuaresh, vendosje bordurash) dhe KUB e KUZ, sinjalistike rrugore.
Buxheti 2012	Buxheti i akorduar nga Bashkia për këtë Program, për vitin 2012 paraqitet në shumën prej 428.504.092 lekë ose 24 % të totalit të shpenzimeve. Ky program për vitin 2012 ka pësuar një ulje në masën 43 %.
Njësitë shpenzuese	Bashkia Durrës Ndermarrja e rrugeve

Programi I Infrastrukturës Rrugore	Plani 2011	Plani 2012
Shpenzime korrente	33.260.000	33.791.000
Shpenzime kapitale	718.860.869	394.713.092
T O T A L I	752.120.869	428.504.092

Shpenzimet kapitale për vitin 2012

Shpenzimet kapitale per kete program jane planifikuar ne vleren 394.713.092 leke, te ndara si me poshte:

- Studime projektme 10.382.080 leke
- Investime 384.331.012 leke

Objekte të reja për vitin 2012:

Emertimi I objektit	Vlera e plote	Fondi per vitin 2012
1. Projekt zbatimi per promenaden bregdetare dhe plazhin public nga berryli deri ne Currila	21.000.000	5.000.000
2.Projekt zbatimi per mbylljen e kanaleve ne plazh dhe shkozet	5.000.000	5.000.000
3. Nderrim i tubacioneve te ujesjelles kanalizimeve (bashkefinansim me Nd. E ujesjellesit)	2.400.000	2.400.000
4.Rik. rruga K.Miho	10.000.000	4.000.000
5.Rik. Kuartalla ndermjet rruges Mustafa Pashe Bushati dhe B.Tusha	3.000.000	3.000.000
6.Rik.kuartalle ne Shkozet ne kufi me fundin e rruges K.Vila (tek tuneli)	3.000.000	3.000.000
7.Rik.rruget:V.Manushi,Shpresa, Gloria, T.Noga	31.000.000	10.000.000
8.Rik. rruge ne plazh Milto Kulja , segment rruga Qafebot dhe vazhdimi deri tek rr.Pavaresia	25.000.000	10.000.000
9.Rik . shetitorja Taulantia (Faza II)	125.000.000	25.000.000
10.Ndertim kabine elektrike tek stadium N.Dovana	5.000.000	5.000.000
11.Rik. Kuartalla ne L.17 kufizuar me rruget: Lura dhe I.Metalia	65.000.000	15.000.000
12.Rik. rruge dhe kuartalla tek rr.V.Kuqi	8.000.000	8.000.000
13.Rik. kuartalla ne L.18 (faza II)	80.000.000	20.000.000
14.Mbyllje kanali ne Plazh	2.500.000	2.500.000
15. Rikonstruksioni ruges se Parthineve	12.000.000	12.000.000
16. Rikonstruksion I rruges se shqipeve	10.000.000	10.000.000
TOTALI	407.900.000	139.900.000

Objekte në vazhdim që përfundojnë në 2012

Emertimi i objektit	Fondi
1. Rikostruksion I Bukevardit kryesor	78.119.480
2.Rehabilitim Shetitores begdetare	18.555.772
T O T A L I	96.675.252

Objekte për efekt financimi

Emertimi i objektit	Fondi
1. Rikonstruksion rehabilitim te hapësirave , fasadave te pallateve ne hyrje te Duresit Loti I	12.000.000
2. Rikonstruksion rruge ne lagjen nr.5	1.498.848

3. Asfaltim rruge te brendshme ne qytet	720.000
Rikonstruksion kanli ne L.14 Shkozet	873.348
Rik. rehabilitim hapësirave ne blloqet pergjate rr.N.Libohova	7.700.000
Rik. rruges Kreugu	481.200
Rik. rruges rezidenciale plazh, rr. tek ish befotrofi, kuartalla prapa shk.N.Tereza	1.941.024
Rik. rruge ne Plazh	6.750.806
9. Rik. rruge te brendshme ne Plazh	3.499.932
10. Rehabilitim, rik. I kuartallave ne L.16	2.165.796
11. Rik. kuartalles prapa Blu Star	1.360.000
12. Rik. kuartalle perballe spitalit	1.450.000
13. Rehabilitim,rik. I kuartallave ne lagjen 5	4.900.000
14. Rik. rruges unaza shkolla spitalle kenete (glaukia)	22.238.946
15. Rik. rruge frigorifer plazh	12.003.306
16. Blerje asfaltobeton (Nd.rruga)	352.318
17. Projekt zbatimi per rehabilitimin e territorit te blloqeve te banimit tek N.Libohova.	382.080
17. Supervizime kolaudime	3.404.332
T O T A L I	143.137.840

PROGRA

MI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Përshkrimi i programit	Programi i shërbimeve publike parashikon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe pajisjen e tyre me të gjithë elementët e nevojshëm për sigurimin e një mjedisi bashkëkohor.
Politika e programit	Politika e këtij programi konsiston në ofrimin me cilësi, sipas standardeve bashkëkohore dhe konform legjislacionit të shërbimeve publike në të gjithë qytetin, për të siguruar një qytet të mirëshërbyer në infrastrukturë publike.
Objektivat e politikës së programit	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Ndërhyrjet komplekse në infrastrukturën rrugore nën dhe mbitokësore nëpërmjet investimeve në: <ul style="list-style-type: none"> – Rikualifikime urbane të hapësirave publike dhe Shesheve të qytetit, – Mobilime urbane. ❖ Përmirësimin dhe garantimin e shërbimeve publike që sigurojnë: <ul style="list-style-type: none"> – Shtimin e hapësirave të gjelbra dhe mirëmbajtja e hapësirave ekzistuese, – Shërbimin e largimit publik të mbeturinave, – Trajtimin e mbetjeve urbane, – Mirembajtjen e ndricimit te qytetit dhe dekorin – Mirëmbajtjen e varrezave,

	– Ndërhyrjet e nevojshme të Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik
Buxheti 2012	Bashkia vazhdon ta ketë në prioritet edhe për vitin 2012 ofrimin me cilësi e sipas standardeve bashkëkohore të të gjitha shërbimeve publike, me qëllim sigurimin e një infrastrukturë publike me të gjithë elementët e saj të nevojshëm. Buxheti i akorduar nga Bashkia për këtë program paraqitet në shumën 597.468.806 lekë ose 34 % e totalit të shpenzimeve. Ky program për vitin 2012 ka pësuar një ulje në masën 4% krahasuar me 2011.
Njësitë shpenzuese	Bashkia Durres, Nd.sherbimeve komunale, Nd.kom. Plazh, Nd.Rrugeve.

Shpenzimet kapitale për vitin 2012

Objekte të reja për vitin 2012:

Emertimi i objektit	Vlera e plote	Fondi per vitin 2012
1. Vlersim ndikimi mjedisor per planin urbanistik	2.500.000	2.500.000
2. Studim per rishikimin e planit urbanistik dhe pershtatjen e tij me termat dhe konceptet e ligjit 10119 dt.23/04/2009,ndryshimet ne projekt pas komenteve te publikut	400.000	400.000
3.Studim per zhvillimin e turizmit dhe tipet e tij ne perputhje me planin e ri urbanistik	400.000	400.000
4. Studim per planifikimin e zhvillimit te infrastruktures dhe azhornimin e infratrutures ekzistuese	400.000	400.000
5. Studim mbi planifikin e zhvillimit te zones ekonomike nen territorin ne administrim te Bashkise sipas planit te ri urbanistik	400.000	400.000
6. Studim mbi rishikimin e rregullores vendore te planifikimit dhe pershtatjen me terminologjine e ligjit te ri ripunime hartash.	400.000	400.000
7. Rivitalizim sheshit para Tirana Bank kufizuar me rr. K.Rama dhe rruga deshmoreve	5.000.000	5.000.000
8. Rikualifikim fasadash	40.000.000	15.000.000
4. Gjelberim ne qytet	39.068.700	39.068.700
5. Ndertim banjo ne plazh	6.000.000	6.000.000
6. Blerje kamioncine	800.000	800.000
TOTALI	95.368.700	70.368.700

Objekte në vazhdim që përfundojnë në 2012

Emertimi i objektit	Fondi
1. Rehabilitim sheshit tek stacioni I trenit	77.389.015

Objekte për efekt financimi

Emertimi i objektit	Fondi
1. Studim projektim per Waterfrontin perendimor	7.190.400
2. Rehabilitim hapësirave Brenda varrezave të reja	1.526.880
Rik. dhe rehabilitim sheshit tek A.Hajdari	5.520.000
Rivitalizim sheshit Liria (faza I)	28.045.022
Rikualifikime të fasadve në qytet	1.891.999
Supervizime kolaudime	2.248.790
T O T A L I	123.812.106



Pastrimi i qytetit

Sherbimi i pastrimit ne Bashkine Durres realizohet nepermjet 2 ndermarrjeve bashkiake : Ndermarrjes se sherbimeve komunale dhe Ndermarrjes Komunale Plazh .

Ndermarrja e sherbimeve komunale e shtrin sherbimin e saj ne te gjithë qytetin deri ne fshatin Rinia, me nje siperfaqe totale 1.575.930 m2. Ne sektorin e pastrimit do te jene te punesuar 239 vete, i njeiti numer me vitin 2011. Ketu perfshihet pastrimi i rrugeve dhe kuartallave , transporti i mbetjeve urbane, fusha e kompostimit te plehrave, sherbimi dezinfektim –deratizim. Sherbimet kryesore qe ajo do te kryeje jane si me poshte:

- Grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane me 760 konteniere me kapacitet 1,1 m3 dhe 29 konteniere me kapacitet 2.4 m3
- Shërbimi i pastrimit dhe dezinfektimit të kontenierëve (23670 konteniere ne muaj, 284040 ne vit)
- Mirëmbajtja e vend grumbullimit të mbetjeve gjate ditës (366 VMM x 6 m2 per VMM) dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme
- Fshirja rrugë dhe trotuare e 876.000 m2 në ditë,
- Mirëmbajtje e krehje kuartallash (670 000 m2 në ditë),
- Larja e rrugeve 1 here ne dite e 41.000 m2 rruge per 7 muaj te vitit dhe 2 here ne dite e 82.000 m2 per 5 muaj te vitit.

Ndermarrja komunale plazh e shtrin sherbimin e saj ne zonen e Shkozetit dhe plazhit me nje siperfaqe prej 11 mije km2. Ne sektorin e pastrimit edhe per vitin 2012 do te jene te punesuar 105 vete, nga keta 30 vete jane punetore sezonale qe punojne ne periudhen prill –gusht , pra gjate fazes parapergatitore per hapjen e sezonit tuistik dhe gjate sezonit. Gjithashtu prane kesaj ndermarrjedo te vazhdoje te aplikohet skema e puneve ne komunitet. Per kete vit fondi i parashikuar per kete qellim eshte 1.500.000 leke i ndare: paga 1.285.405 leke dhe sigurime shoqerore 214.595 leke . Ne kete skeme do te perfshihen persona qe do te perfitojne ndihmen e konomike nepermjet puneve per pastrimin dhe mirembajtjne e territorit te vijes bregdetare pergjate Plazhit.

Sherbimet kryesore nga kjo Ndermarrje do te jene per pastrimin , mirembajtjen , dezinfektimin e 298 525 m2 rruge te asfaltuara, 68695 m2 trotuare, 186831 m2 rruge te paasfaltuara, 172.800 m2 siperfaqe rere.

Buxheti i pastrimit sipas zonave dhe njesive shpenzuese qe e kryejne kete sherbim, për vitin 2012, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Njesia shpenzuese/ndermarrja	Vlera ne lekë
Nd.sherbimeve komunale	
Shp. Personeli	133.756.000
Shp.operative	44.000.000
Nd.kom.plazh	
Shp. Personeli	58.546.000

Mirëmbajtja dhe shtimi i hapësirave të gjelbra

Sipërfaqet e gjelbra përbëjnë një ndër prioritetet kryesore për qytetarët të cilët presin jo vetëm shtimin e parqeve dhe ambienteve publike të gjelbëruara, por edhe në arritjen e normave të qyteteve të zhvilluara për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara si edhe shtimin e ambienteve publike, social kulturore e sportive.

Edhe ky shërbim kryhet nga 2 Ndermarrjet sipas zonave të pastrimit që ato mbulojnë.

Për përmbushjen e këtij funksioni sektoret perkates prane ketyre 2 Ndermarrjeve do të realizojnë si çdo vit edhe për 2012 shërbimet si më poshtë :

- Mirëmbajtjen e 142.457 m² lulishte dhe 40.000 m² parqe,
- Shërbimin e nevojshëm agroteknik për mirëmbajtjen e 4069 drurë rrugorë , 1786 shkurre decorative në rrugë, 2083 drurë dekorative e 2260 shkurre decorative në parqe e lulishte,
- Vetëm për sezonin nëntor 2011- mars 2012 parashikohet mbjellja e 60 drurëve të rinj si: palma, likujdambra, frasher etj. në qytet.

Fondet për gjelberimin e qytetit (shp.korrente dhe investime)për vitin 2012 kapin shifren 99.000.700, ku 39.068.700 leke (10% e transfertes së pakushtezuar) do të financohen nga transferta e pakushtezuar për gjelberim sipas vendimeve dhe udhëzimeve që do të dalin për këtë qëllim nga Qeveria.

Sherbimi i ndricimit, dekorit dhe funeralit

Sherbimi I ndricimit dhe dekorit që kryhen nga ndermarrja e shërbimeve Komunale duke filluar nga muaji maj i kalojnë për administrin Ndermarrjes së rrugëve . Prandaj kësaj ndermarrje do të funksionojnë sektoret perkates për kryerjen e ketyre shërbimeve, sektori i ndricimit me 8 punonjës dhe sektori i dekorit me 3 punonjës. Sektori i mirëmbajtjes së varrezave me 15 punonjës do të vazhdojë në administrim të Ndermarrjes së shërbimeve. Shpenzimet për energjinë e ndricimit të rrugëve , trotuareve dhe hapësirave publike janë parashikuar në vlerën 53.000.000 leke.

Tabela e mëposhtme paraqet **shpenzimet korrente** për shërbimet publike:

Shërbimet Publike	Plani 2012 Shp. korrente
Pastrimi	264.550.000
Gjelbërimi	59.932.000
Dekori	7.573.000
Mirëmbajtja varrezave	9.072.000
Mirëmbajtja e ndricimit	9.161.000
Energjia ndricimit rrugor	53.000.000
Total	403.288.000

PROGRAMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE EDUKIMIT

Përshkrimi i programit	Programi i arsimit parashikon ndërhyrjet për ndërtimin e rikonstruksionin e objekteve të reja shkollore dhe parashkollore, pajisjen dhe kompletimin e tyre me bazë materiale, si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme
Politika e Programit	Konsiston në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies me synim arritjen e standarteve optimale bashkëkohore mësimore për të gjithë.
Objektivat e politikës së programit	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Vlerësim nevojash dhe studime për prioritetet afatmesme dhe afatgjata dhe studime për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në qytetin e Durrësit duke përfshirë investimin dhe mirëmbajtjen e tyre si dhe social – arsimore në fushën e edukimit. ❖ Ndërhyrje me investime në arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm, ndërtimit dhe rikonstruksionit të objekteve ❖ Ndërhyrje me investime në arsimin parashkollor. Ndërhyrje në kopshte për plotësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme dhe për pajisjen me të gjithë elementët e nevojshëm si në mjediset e jashtme duke krijuar një infrastrukturë argëtuese dhe edukative për fëmijët dhe komunitetin ashtu edhe në ambjentet e brendshme me pajisjen me kuzhina profesionale etj. për ofrimin e një shërbimi cilësor për fëmijët. ❖ Edukimin e brezit të ri, nëpërmjet politikave të caktuara sociale, kulturore dhe edukative.
Buxheti 2012	<p>Arsimi parashkollor e para-universitar është një funksion i përbashkët i Njërive të Qeverisjes Vendore dhe Pushtetit Qendror.</p> <p>Bashkia e Durrësit administron aktualisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 6 kopshte me ushqim – 3 kopshte pa ushqim – 20 shkolla 9-vjeçare dhe 8 shkolla të mesme të përgjithshme, – 2 konvikte të shkollave të mesme profesionale <p>Buxheti i akorduar nga Bashkia për këtë Program, për vitin 2012 paraqitet në shumën prej 147.918.396 lekë ose 8.2 % të totalit të shpenzimeve.</p>
Njësitë shpenzuese	Bashkia Durrës, Qendra ekonomike e arsimit, Q.kulturore fëmijeve

Programi i Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit	Plani 2011	Plani 2012
Shpenzime Korrente	87.010.000	84.004.000
Shpenzime Kapitale	8.693.442	63.914.396
TOTALI	95.703.442	147.918.396

Shpenzimet korrente për vitin 2012

Në tabelën e mëposhtme paraqiten shpenzimet operative për programin e arsimit:

Shpenzime korrente për arsimin	Plani 2012
Sigurimi ushqimit femijeve ne kopshte	26.000.000
Sigurimi ngrohjes femijeve ne kopshte	3.500.000
Te tjera per funksionimin e koshteve & shkollave 9 vjecare	16.117.000
Mirembjatje e te tjera per funksionimin e shkollave te mesme	3.850.000
Ushqimi për menecat e konvikteve te shkollave të mesme	2.600.000
Te tjera per funksionimin e tyre	5.260.000
Funksionimi i Q.kulturore te femijeve	2.500.000
Projekte per aktivitete te femijeve	2.000.000
Shpenzime personeli konvikteve	15.507.000
Vendime gjyqsore	466.000
Qeraja e shkolles B.Curri	4.704.000
Stimulimi I nxenesve me dhjeta	1.500.000
Total	84.004.000

Shpenzimet kapitale për vitin 2012:

Objekte të reja për vitin 2012:

Emertimi i objektit	Fondi per vitin 2012
1.Rik.kopshti 1 Qershori	5.000.000
2.Rik.palestra shk. Sh.Mazreku	800.000
3.Rrethimi shkolles Gj.Kastrioti	2.000.000
4.Blerje pajisje per konviktet	300.000
5.Rikonstruksion I shkolles N.Frasherit	25.000.000
6.Rikonstruksion I shkolles J.Kukuzeli	26.300.000
TOTALI	59.400.000

Objekte për efekt financimi

Emertimi i objektit	Fondi per vitin 2012
1. Rikonstruksion i shkolles K. Lirise	2.726.396
2. Blerje mikrobuz per PLM	1.788.000
TOTALI	4.514.396

**PROGRAMI I TRANSPORTIT PUBLIK
DHE LËVIZSHMËRISË**

Përshkrimi i programit	Programi i Transportit publik dhe lëvizshmërisë parashikon ofrimin e një shërbimi të transportit publik cilësor për qytetarët, një menaxhim më të mirë të trafikut nëpërmjet rregullimit dhe përmirësimit të të gjithë instrumentave dhe elementëve të sinjalistikës rrugore në qytet.
Politika e Programit	Politika e këtij programi konsiston në realizimin e një sistemi të transportit rrugor sipas standarteve bashkëkohore për qarkullimin e mjeteve dhe t'iu ofrojë qytetarëve një qarkullim të shpejtë, komod dhe të sigurt
Objektivat e politikës së programit	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Zgjerim i rrjetit të transportit publik në të gjithë territorin e qytetit, ❖ Rritje të kapaciteteve transportuese, ❖ Përmirësim i infrastrukturës ndihmëse të transportit publik, ❖ Plotësim i të gjitha rrugëve me sinjalistikë vertikale e horizontale me lehtësira për qytetarë me aftësi të kufizuar, ❖ Edukimi e informimi i qytetarëve mbi rregullat e qarkullimit.
Buxheti 2012	Buxheti i akorduar nga Bashkia për këtë Program për vitin 2012 paraqitet në shumën prej 36.800.000 lekë ose 2% të totalit të shpenzimeve.
Njësitë shpenzuese	Bashkia Durrës, Parku urban

Programi i Transportit Publik dhe Lëvizshmërisë	Plani 2011	Plani 2012
Subvencioni I Parkut Urban	35.000.000	35.000.000
Projekti ADRIMOB		1.800.000
TOTALI	35.000.000	36.800.000

Projekti ADRIMOB është një nga 3 projektet perfituese të Programit IPA Adriatic Cross Border Cooperation 2007-2013 dhe është në përputhje me prioritetin 3 të Programit IPA. Ai synon favorizimin e zhvillimit të sistemit të transportit të qëndrueshëm përgjatë brigjeve të Adriatikut, si dhe thellimin e tyre.

Buxheti i projektit është 183.800,00 € .Financimi i B.E.: € 161.500,00 (85% e buxhetit të projektit).Financimi kombëtar publik nga Bashkia Durrës € 28.500,00 (15% e buxhetit të projektit)

Projekti ADRIMOB përfshin portet kryesore të Adriatikut zones nder-kufitare. Venecia, Ravenna, Rimini, Cesenatico, Pesaro Urbino, Pescara, Brindisi, Bari, Rovinj, Rab, Split, Durrës, Bar, Igumenicë.

Projekti është përcaktuar duke marrë parasysh problemet e veçanta të identifikuar duke filluar që nga panorama e përgjithshme për politikën e BE-së në fushën e lëvizshmërisë të qëndrueshme, analiza e situatës së Mobilitetit në zonën e Adriatikut, deri në gjendjen specifike të artit dhe problemet e ngritura nga partnerët në këtë fushë, si dhe rritjen reale të vazhdueshme të biznesit dhe turizmit, veprimtarive ndërmjet vendeve të Adriatikut. Ky projekt synon përcaktimin dhe strukturimin e një sistemi levizës efikas dhe më pak ndotës, si për mallra dhe pasagjerë. Kjo do të thotë të përqëndrohemi në çështje të veçanta të tilla si: transport publik, porte, qendra multimodale, fasilite për biçikleta e kështu me radhë. Nevoja është planifikimi i një strategjie të integruar të transportit të qëndrueshëm, për të favorizuar lëvizjen e qëndrueshme të rritjes së numrit të njerëzve që udhëtojnë për arsye të ndryshme: punë, turizëm, biznes, etj. Kjo do të arrihet duke forcuar dhe integruar rrjetet ekzistuese të infrastrukturës, me zhvillimin dhe modernizimin e transportit dhe të komunikimit të shërbimeve.

Objektivat specifike janë:

Të inkurajojmë fuqimisht dhe favorizojmë përdorimin e transportit detar për pasagjerët ndërmjet dhe përgjatë dy brigjeve;

Përforcimi dhe integrimi rrjeteve ekzistuese të infrastrukturës dhe strukturën dhe promovimin e lidhjeve të reja / plotësuese midis porteve dhe me ne brendësi, për të përfutur përvojat e partnerëve të fituar gjatë periudhës së programimit, për të krijuar mundësi të reja pune, për të përmirësuar / forcuar rrugët detare, për të inkurajuar autoritetet publike përkatëse në zonën e Adriatikut, për të përmirësuar nivelin e cilësisë dhe efektivitetit të sigurisë së lundrimit dhe mbrojtjen detare të mjedisit në pellgun e Adriatikut, të gjitha duke zbatuar direktivat përkatëse të KE-së, që kanë për qëllim arritjen e zhvillimit të transportit dhe trafikut detar të qëndrueshëm në këtë zonë.

Rezultatet kryesore të pritura janë: kompletimi rrjeteve ndër-kufitare të qarqeve multimodale, në mënyrë që të rritet përdorimi i mjeteve të transportit alternativ dhe jo më me makinë dhe uljen e emetimeve të CO2, për të përcaktuar ofertën e transportit të zonës së Adriatikut dhe rritja e konkurrencës së vazhdueshme të saj , një rritje e ndërgjegjësimit të njerëzve dhe autoriteteve publike për lëvizshmërinë e qëndrueshme, si dhe një rritje të ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe autoritetet publike mbi nevojën e një mbrojtje më të mirë të mjedisit detar dhe bregdetar.

Ky projekt përbehet nga 5 plane pune si ne vijim: WP1-menaxhimi i projektit dhe kordinimi, WP2- komunikimi dhe shpërndarja, WP3- përcaktimi i një strategjie të Adriatikut nderkufitar për zbatimin e levizshmërisë multimodale, WP4- definicioni dhe organizimi i qëndrueshëm nderkufitar i qarqeve multimodale, WP5-marketing e qark multimodal

PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL

Përshkrimi i programit	Programi i strehimit parashikon zhvillimin e politikave për zbutjen e problemit të strehimit për të gjitha shtresat në nevojë të klasifikuara sipas kritereve të përcaktuara me akte ligjore e nën ligjore.
Politika e Programit	Politika e këtij programi konsiston në zgjerimin e programit të strehimit për të siguruar integrim social për të pastrehët dhe të gjithë kategoritë në risk, me qëllim zbutjen e mëtejshme të këtij problemi.
Objektivat e politikës së programit	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Ndërtimi i banesave sociale për strehimin e shtresave në nevojë, ❖ Evidentimi i trojeve që mund të përdoren për programet sociale të strehimit, ❖ Evidentimi i objekteve që kanë dalë jashtë funksionit të cilat mund të adaptohen për objekte të strehimit social, ❖ Kërkesë për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit duke aplikuar me programe konkrete, ❖ Nxitjen e partneritetit publik-privat për sigurimin e banesave për të pastrehët, ❖ Mbulimin me bonus të qerasë për familjet në nevojë, ❖ Studimi për sigurimin e ndërtimit të apartamenteve sociale me qira dhe apartamente me kosto të ulët, ❖ Studim për mundësinë e blerjes se apartamenteve në tregun e lirë.
